



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 9.6.2023

Nr: 664

Ora: 12:00

VENDIM
PËR

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË
KURBIN, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenit 162 dhe nenit 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VËREN:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "i", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendore, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor me vendimin nr. 674, datë 17.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Kurbin. Kundër vendimit të sipërcituar të KZAZ-së u administrua kërkesa ankimore nr. 77, datë 22.5.2023, e depozituar nga subjekti zgjedhor "Aleanca Progresiste LZHK", me objekt:

- Ndryshim i vendimit nr. 74, datë 17.5.2023, të KZAZ-së nr. 15, Kurbin, për shpalljen e pavlefshme të kutisë së QV nr. 0907;
- Numërimin e votave që gjenden në kutinë e QV nr. 0907, që i përket fshatit Shpërdhet, njësia administrative Mamurras, Bashkia Kurbin.

Më datë 29.5.2023, ora 13:20, në seancën e shqyrtimit Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 77, datë 22.5.2023, të depozituar nga subjekti zgjedhor "Aleanca Progresiste LZHK".
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 74, datë 16.5.2023 të KZAZ-së nr. 15, Kurbin.

Kundër vendimit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve nr. 160, datë 29.5.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 77, datë 22.5.2023, të paraqitur nga "Aleanca Progresiste LZHK", pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor,

Data: 9.6.2023 Nr: 664
Ora: 12:00



"Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Kurbin, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

është paraqitur për shqyrtim çështja nr. 27 Regj. Themeltar, datë 05.06.2023, me ankues Partia Aleanca Progresiste LZHK, me objekt:

- Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve nr.160, datë 29.05.2023, për shqyrtimin e kërkesës nr. 74, datë 17.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për subjektin politik "Aleanca Progresiste LZHK".
- Detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të konsideruar të vlefshme rutinë për këshillin bashkiak Kurbin, Qendra e Votimit nr. 0907, i cili i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin.

Më datë 7.6.2023, ora 08.30, në përfundim të seancës së shqyrtimit Kolegji Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, vendosi rrëzimin e kërkesë padisë.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe nenit 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përlllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për subjektet zgjedhore, për Këshillin e Bashkisë Kurbin, pasqyrohet në tabelën nr.1 në vijim:

(Tabela nr. 1)

Nr. FV	Subjekti Zgjedhor	Vota	Përqindja
1	Bashkë Fitojmë	3468	16,39 %
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	4638	21,92 %
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	605	2,86 %
4	Partia Republikane Shqiptare	1038	4,91 %
5	Partia Lëvizja e Legalitetit	673	3,18 %
6	Partia Demokracia Sociale	1184	5,59 %
7	Aleanca Liberale e Djathtë	166	0,78 %
8	Partia Socialdemokrate	1555	7,35 %
9	Partia Demokratike	998	4,72 %
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	977	4,62 %
11	Fryma e Re Demokratike	129	0,61 %
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	652	3,08 %
15	Bindja Demokratike	332	1,57 %
18	Partia Balli Kombëtar	193	0,91 %
19	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	397	1,88 %
23	Partia e Gjelbër	554	2,62 %
27	Partia Kombëtare Konservatore Albania	609	2,88 %
33	Partia Ora e Shqipërisë	163	0,77 %
34	Partia Kristian Demokrate	132	0,62 %

35	Nisma Thurje	459	2,17 %
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	297	1,40 %
41	Diogjen Gjergj Kolici	1245	5,88 %
42	Rinaldo Agustin Piroli	698	3,30 %
	Totali	21162	100 %

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 31 (tridhjetë e një) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Kurbin, në bazë të shkresës nr. 189/1 Prot., datë 24.2.2023, të Prefektit të Qarkut Lezhë.

Herësit e përfitur nga ky pjesëtim janë në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përfitur nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 31 (tridhjetë e një). Nga kjo renditje marrim rezultatin e pasqyruar në tabelën nr.3, në vijim:

(Tabela nr.3)

Nr.	Herësi	Subjekti
1	4638	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	3468	Bashkë Fitojmë
3	2319	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	1734	Bashkë Fitojmë
5	1555	Partia Socialdemokrate
6	1546	Partia Socialiste e Shqipërisë
7	1245	Diogjen Gjergj Kolici
8	1184	Partia Demokracia Sociale
9	1159	Partia Socialiste e Shqipërisë
10	1156	Bashkë Fitojmë
11	1038	Partia Republikane Shqiptare
12	998	Partia Demokratike
13	977	Aleanca Progresiste L.ZH.K
14	927	Partia Socialiste e Shqipërisë
15	867	Bashkë Fitojmë
16	777	Partia Socialdemokrate
17	773	Partia Socialiste e Shqipërisë
18	698	Rinaldo Agustin Piroli
19	693	Bashkë Fitojmë

20	673	Partia Lëvizja e Legalitetit
21	662	Partia Socialiste e Shqipërisë
22	652	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
23	609	Partia Kombëtare Konservatore Albania
24	605	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë
25	592	Partia Demokracia Sociale
26	579	Partia Socialiste e Shqipërisë
27	578	Bashkë Fitojmë
28	554	Partia e Gjelbër
29	519	Partia Republikane Shqiptare
30	518	Partia Socialdemokrate
31	515	Partia Socialiste e Shqipërisë

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në tabelën nr.3.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve të pasqyruar në tabelën nr.4, në vijim:

(Tabela nr.4)

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Mandate
1	Bashkë Fitojmë	6
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	9
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	1
4	Partia Republikane Shqiptare	2
5	Partia Lëvizja e Legalitetit	1
6	Partia Demokracia Sociale	2
7	Partia Socialdemokrate	3
8	Partia Demokratike	1
9	Aleanca Progresiste L.ZH.K	1
10	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	1
11	Partia e Gjelbër	1
12	Partia Kombëtare Konservatore Albania	1
13	Diogjen Gjergj Kolici	1
14	Rinaldo Agustin Piroli	1

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenet 162 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOS:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Kurbin, si më poshtë:

Subjekti Zgjedhor	Mandate
Bashkë Fitojmë	6
Partia Socialiste e Shqipërisë	9
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	1
Partia Republikane Shqiptare	2
Partia Lëvizja e Legalitetit	1
Partia Demokracia Sociale	2
Partia Socialdemokrate	3
Partia Demokratike	1
Aleanca Progresiste L.ZH.K	1
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	1
Partia e Gjelbër	1
Partia Kombëtare Konservatore Albania	1
Diogjen Gjergj Kolici	1
Rinaldo Agustin Piroli	1

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Kurbin, si më poshtë:

Bashkë Fitojmë

1.	Melisa	Can	Kalaja
2.	Ded	Mark	Ndreca
3.	Dea	Artur	Çoku
4.	Albert	Pjeter	Ndoci
5.	Sabaete	Fatmir	Hidri
6.	Dorian	Fran	Tusha

Partia Socialiste e Shqipërisë

1.	Agron	Gjergj	Ivani
2.	Edlira	Fran	Lleshi
3.	Leonard	Lek	Trokthi

4.	Albana	Lazër	Gjetaj
5.	Krenar	Dilaver	Kasmi
6.	Gezime	Islam	Veseli
7.	Luigj	Nikoll	Lepuri
8.	Erisa	Bedri	Gjoni
9.	Estri	Martin	Keci

Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë

1.	Anton	Ndue	Kolziu
----	-------	------	--------

Partia Republikane Shqiptare

1.	Eris	Fran	Zymaj
2.	Romina	Can	Isufi

Partia Lëvizja e Legalitetit

1.	Ilir	Bajram	Myrta
----	------	--------	-------

Partia Demokracia Sociale

1.	Pashk	Pal	Prenga
2.	Aida	Frrok	Skeja

Partia Socialdemokrate

1.	Etmond	Mark	Stojani
2.	Gjele	Zef	Stojani
3.	Mirash	Lek	Huli

Partia Demokratike

1.	Aleksander	Rrok	Jakaj
----	------------	------	-------

Aleanca Progresiste L.ZH.K

1.	Elton	Dod	Laska
----	-------	-----	-------

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet

1.	Altin	Nikoll	Bruka
----	-------	--------	-------

Partia e Gjelbër

1.	Marjana	Ndrec	Gjini
----	---------	-------	-------

Partia Kombëtare Konservatore Albania

1.	Sefedin	Hajdar	Likaj
----	---------	--------	-------

Kandidatë propozuar nga zgjedhësit

1. Diogjen Gjergj Kolici
2. Rinaldo Agustin Piroli
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

